

Si Të Gjesh Të Dashurën E Zembrës?

Kjo pjesë është shtesë e serisë **Jeta e Beqarit**, e cila përfundoi javën e kaluar. I motivuar sidomos nga ky grup të rinjsh, por edhe nga dëshira juaj për martesë, po ndaj me ju këtë mesazh sot. Dikush ka thënë: "Zgjedhjet që bëni në jetë përcaktojnë si do ta kaloni përjetësinë." Kjo është shumë e vërtetë kur ti bën zgjedhjen për t'i besuar Jezusit, sepse nëse Ai është Zoti dhe Shpëtimtari yt, ti keni siguruar biletën për të hyrë në qiell.

Por gjithashtu, vendimi i dytë më i rëndësishëm në jetë, pas vendimit për të pranuar Jezusin, është: Me kë do të martohem? Ka shumë evidenca për vendimmarrjen e gabuar në këtë rast, pasi shikon njerëz të martuar me zemra të thyer, që dhunohen emocionalisht dhe fizikisht. Dëgjoni për ndarje çdo javë. Nuk e di sa ka shkuar numri i divorceve në Tiranë tani, por para disa vitesh ishte 10 divorce në javë. Dhe 8 nga këto ishin martesë në 2 vitet e para të martesës.

Pse ndodhin këto gjëra? Sepse nuk ka mësim për këto gjëra; nuk të tregon kush se si ta zgjedhësh personin me të cilin duhet të martohesh.

Ja, ta filloj me një deklaratë të vështirë që nga fillimi: Perëndia nuk e zgjedh personin me të cilin do të martohesh ti; Ai e ka lënë në dorën tënde. Perëndia të udhëzon se si duhet të jetë ai person, por nuk e zgjedh për ty. Nuk ka vetëm një person të përsosur në tokë për ty, një person të vetëm që plotëson vullnetin e Perëndisë.

Shaka: Një çift që po divorcohej, avokati po bisedonte me gruan dhe i tha: "A keni bërë atë betimin, 'do të të dua gjithmonë, në të mirë e në të keq?'" Gruaja i tha: "E kemi bërë, por ky paska qenë më i keq se sa e mendoja unë."

Cili është vullneti i Perëndisë, si ta kuptoj se me kë të martohem? Perëndia përdor 5 mënyra, 5 stacione, kanale me të cilat komunikon me ne, që të sigurohemi nëse është ose jo ai personi i duhur:

1. Me anë të Biblës. Ai të flet ty me Fjalën e Tij.

Psalmi 119:105 *"Fjala jote është një llambë në këmbën time dhe një dritë në shtegun tim."*

Sa më shumë ta kuptosh Biblën, aq më qartë do ta kuptosh atë që dëshiron Perëndia nga ti. Sigurohu që vargu ose pjesa që mendon se po të flet Perëndia është brenda kontekstit, dhe jo të hapësh Biblën dhe të vësh gishtin në ndonjë vend të rastësishëm. Sepse nuk ka shumë vajza me emrat që janë në Bibël, si Jezebela, Debora, Rakela.

Një gjë është e sigurt: sa më mirë që e njeh këtë libër, aq më qartë është ajo që të thotë Perëndia. Ndoshta kjo është një arsye më shumë për të lexuar Biblën. Një shoku im, të cilin e kam pasur dhe mësues në shkollën e Biblës, tha se hera

e parë që e kishte lexuar Biblën e tërë për 2 muaj ishte kur donte të sigurohej nëse vajza që donte ishte sipas vullnetit të Zotit apo jo.

2. Me anë të Përshtypjeve.

Fryma e Shenjtë vendos ide dhe përshtypje tek ne në lidhje me dikë. Dhe ti thua: A e shikoj këtë person si gruan time dhe si nënën e fëmijëve të mi? Ose ndryshe: A e shikoj këtë djalë si burrin tim, me të cilin do të zgjohem çdo mëngjes dhe si babain e fëmijëve të mi?

Dallo ndryshimin mes Tundimit dhe Frymëzimit. Jo çdo përshtypje e mirë vjen nga Zoti. Një përshtypje e mirë mund të vijë nga emocionet momentale, nga situata që u krijua, nga hormonet, apo nga shumë gjëra të tjera. Prandaj, përdore këtë për të mbështetur të tjerat, jo për të marrë vendim.

3. Me anë të Rrethanave dhe Situatave.

Si u takuat, si filloi? Duke ditur se asgjë nuk ndodh rastësisht dhe se Perëndia i shkakton gjërat të ndodhin për një qëllim. U takuat tek kisha, në një seminar, në kamp, në një kafe me shoqërinë tënde... Jeni në një moshë, apo të dy beqarë dhe në kërkim, apo të dy e pëlqeni njëri-tjetrin. Duhet të ketë rrethana që tregojnë se ka diçka të veçantë mes jush. Por mos harro se jo çdo situatë është nga Zoti.

Mos përdor vetëm një nga këto gjëra për të marrë vendim; duhet të jenë të sinkronizuara të pesta. Nëse nuk përputhen të pesta, prit edhe pak.

4. Me anë të Arsyes (Logjikës). Fjalët e Urta 18.

Përdor trurin, logjikën. Ka disa gjëra për të cilat ti nuk ke nevojë të lutesh, por thjesht logjiko dhe vendos se çfarë do të bësh. Për shembull, nëse je mbi shinat e trenit dhe treni po vjen drejt teje, çfarë bën? Lutesh, “O Zot, cili është vullneti yt, çfarë të bëj?” Jo, ti thjesht përdor logjikën dhe largohesh.

Asnjëherë mos hyr në ndonjë lidhje pa mbledhur faktet dhe informacionin se kush është dhe si është. Kushdo që nis një biznes bën llogaritë një herë dhe pastaj fillon, nuk fillon dhe pastaj shpreson që gjërat do të shkojnë mirë. Aq më shumë në një marrëdhënie afatgjatë, sa gjithë jeta. Duhet të llogaritet, a është ky personi i duhur? A është ky vetvetja, apo hiqet? A është...

5. Me anë të këshillës nga të krishterët e pjekur. Fjalët e Urta 11.

Sidomos nëse je besimtar i ri dhe nuk e njeh mirë Biblën, të duhet patjetër këshilla e besimtarëve që ti beson se e njohin më shumë Biblën dhe kanë këshilla për të dhënë për këto gjëra. Nëse këshillohesh para se të marrësh një vendim, do t'i heqësh vetes shumë stres dhe dhimbje koke të panevojshme.

Kur do të marrësh një vendim të tillë kaq të rëndësishëm, sigurohu që këto pesë mënyra t'i kesh përdorur patjetër. Nëse nuk i ke të pesta, Perëndia nuk të ka folur akoma në lidhje me atë person, kështu që mos merr vendim akoma. Ligji i Unitetit: Të pesta këto kanë rëndësi; nëse ka konflikte mes këtyre, mos u ngut, prit edhe pak para se të vendosësh. Nëse je akoma konfuz dhe nuk di se çfarë të bësh, prit për më shumë drejtim dhe qartësi. Perëndia nuk nxiton kurrë; nuk do të përgjigjet kur do ti, por kur e sheh Ai të nevojshme.

Kur Perëndia flet për diçka, është akumuluese dhe progresive. Zoti nuk të flet nga qielli, nuk të dërgon SMS. Thuaj 'Po' asaj me kaçurrela, thuaj 'Jo' atij përtacit. Jo, është akumuluese; mblidhën gjërat, të pesta këto, dhe ti bindesh që ajo është, ai është personi i duhur.

Ideja është se nuk ka një person të vetëm që Perëndia e ka përgatitur nga qielli vetëm për ty. Supozojmë tri çifte që duhet të martoheshin bashkë sipas vullnetit të Zotit. Por, nëse djali i parë nuk e dëgjon Zotin dhe shkon e martohet me gruan e dytë... Perëndia nuk e zgjedh personin me kë të martohesh ti, por të udhëzon se me kë të martohesh.

Ai ka vendosur dy kushte, **dy gjëra të pashmangshme që DUHET të keni të njëjtojtë:**

1. Duhet të keni të dy përputhje shpirtërore.

2 Korintasve 6:14-15: *“Mos u vini nën të njëjtën zgjedhë me jobesimtarët. Çfarë ka të përbashkët drejtësia me paudhësinë? Çfarë ka të përbashkët drita me errësirën? Ku takohen Krishti me Beliarin? Ose, çfarë mund të ndajnë me njëri-tjetrin një besimtar dhe një jobesimtar?”*

Të ketë përkushtim frymëror si ty. Të ketë të njëjtin besim si ti.

Nëse ti ia ke dhënë jetën Jezusit Krishtit, nëse Perëndia është i pari në jetën tënde dhe ti do që të kesh dhe të jetosh një jetë të plotë, nuk je i/e lirë të zgjedhësh një person që nuk ka të njëjtin besim si ty. Nëse zgjedh një person tjetër që nuk beson si ti, ti po e vendos atë person mbi Perëndinë.

Ndoshta ti thua: “Po e ndryshoj unë, jam aq i zoti.” Nuk ka shanse, ose janë shumë të pakta. Shumë kanë rrahur kraharorin duke thënë: “Shiko sa do i besojë Zotit ajo, më shumë se sa unë,” dhe ka ndodhur e kundërta. Besimi nuk imponohet tek dikush; ai person duhet të zgjedhë vetë me zgjedhjen e lirë të besojë Perëndinë. Nëse ia imponon, bëhet më keq; i neveritet Zotit fare.

Ndoshta ti thua: “Po, unë do të lutem që ai të ndryshojë.” Nëse më dëgjon mua, mos u lut fare. Për çfarë po lutesh, që Perëndia të ndryshojë mendjen e tij? Kjo

gjë nuk thuhet në Bibël fare. Unë mund të numëroj dhjetëra raste martesash të tilla që kanë shumë probleme, ose që janë ndarë fare për shkak të mungesës së përputhjes shpirtërore.

Kur ti ke probleme dhe ke partnerin tënd me të njëjtën bindje shpirtërore, ju luteni dhe e sillni para Zotit situatën, dhe Zoti vepron. Por kur je vetëm, ai tjetri të tall, të bezdis, nuk të lë.

Do të kesh konflikte. Si do të merreni me fëmijët? Po ata, a do t'i mësosh me parimet e Biblës, apo me idetë e tij/saj? Nuk ka gjë më të vështirë sesa të mos flasësh, të mos bisedosh me personin që do më shumë në jetë për diçka që për ty është më e madhja në jetë, besimi yt tek Perëndia.

2. Duhet të keni të njëjtin qëllim në jetë, të dy në një mendje.

Tek **Amosi 3:3** thuhet: *"A mund të ecin bashkë dy veta, në rast se nuk janë marrë vesh më parë?"*

Nëse ajo ka drejtimin për Sarandë dhe ti për Shkodër, a mund të ecni ju të dy krahu për krahu? Duhet të sqaroni qëllimet tuaja që keni në jetë para se të vendosni të martoheni me dikë. A keni të njëjtat synime? Duhet të keni synime të përbashkëta.

Ajo thotë: "Unë do të iki në Laç për të punuar si doktoreshë," kurse ti thua: "Unë do të iki në Itali për të punuar me djalin e dajës." Mos u marto me dikë nëse nuk keni të njëjtat synime për atë që dëshironi të arrini në jetë. Nëse synimet janë të kundërta, mos u mundo kot.

Mos u marto me idenë se ai/ajo do të ndryshojë mendim, do të ndryshojë sjellje pas martesës; nuk është e vërtetë. Kur martohesh, mos harro këtë: ti ke kontroll vetëm mbi një person, vetëm mbi veten tënde; nuk e ndryshon një person tjetër. Prandaj është shumë e rëndësishme, mos u ngut pa u siguruar më parë që të dy keni të njëjtin synim dhe qëllim në jetë.

Këto dy gjëra të mësipërme duhet t'i kesh. Nuk ka kompromise. Por ka edhe gjëra të tjera që mund t'ju ndihmojnë.

Gjërat Shtesë që duhet të keni: Ngjashmëri personaliteti.

Është shumë e dobishme nëse keni ngjashmëri. Sa më shumë gjëra të përbashkëta të keni, aq më e lehtë do të jetë martesja, aq më kollaj do të rrjedhë jeta juaj martesore. Ndërsa, sa më shumë ndryshime të keni, aq më shumë përplasje do të keni.

Njihni familjen, sepse në familje ajo/ai ka mësuar mënyrën e komunikimit, vlerat e jetës, dhe si i zgjidh problemet. Fol me detaje për këto gjëra, jini të hapur.

Bisedo për nivelin e arsimit, ambiciet që ka për jetën, dhe si i zgjidh problemet. Bisedo edhe për seksin. Shiko dhe vëzhgo familjen; mos bjerë pre e idesë "nuk marr shalqi pa provë." Njerëzit që bashkëjetojnë kanë më shumë shanse për t'u ndarë, dhe njerëzit që bëjnë seks para martesës shpesh përballen me probleme.

Ndryshimet për disa janë tërheqëse, për disa janë shkatërruese. Ndryshimet e mëdha ose do të shkatërrojnë si çift ose do të bëjnë çift model.

Nëse krijohen rrethanat çdo çift mund të bjerë në dashuri. Pyetja nuk është a e do, por A është ky vullneti i Perëndisë për mua?

Isaia 50:11 “Ja, ju të gjithë që ndizni një zjarr, që rrethoheni me ura zjarri, shkoni në flakët e zjarrit tuaj dhe midis urave që keni ndezur! Nga dora ime do të keni këtë: ju do të lëngoni në vuajtje.”

(Nëse doni ta ndriçoni vetë rrugën tuaj, pa ndihmën dhe udhëzimin e Perëndisë, shkoni, jeni të lirë, por do të keni shumë vuajtje dhe mundime që janë të panevojshme.)

- **Përkushtohu ndaj standardeve të Perëndisë:** Mos hiq dorë nga dy gjërat që **DUHEN**.
- **Të dy vendosni Jezus Krishtin si qendër të lidhjes tuaj:** Lutuni bashkë.
- **Merre shtruar:** Mos fillo menjëherë me fjalët e bukura. Përdor logjikën në fillim, jo direkt emocionet. Shiko se si është sjellja e tij/saj, si duket jashtë, por gjithashtu të veshur bukur, si është hunda, etj.
- **Para se të fejoheni, kërkoni këshillim si çift:** Dikush që këshillonte çfite në lidhje me martesën kishte një model që më pëlqen. Ai thoshte: “Nuk do të martoj askënd pa e këshilluar të paktën katër herë.”

Le të lutemi.